



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË



Inspectia
Judiciară

Nr. Prot: 350

Date: 14.02.2022

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të
Republikës së Shqipërisë Dhe Inspektoratit Gjyqësor të
Republikës së Rumanisë lidhur me forcimin e bashkëpunimit
në fushën e përmirësimit të dhënies së drejtësisë

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe Inspektorati Gjyqësor i Republikës së Rumanisë përfaqësuar nga Kreu i Inspektoratit Gjyqësor z. Lucian Netejoru në vijim referuar si "Palët",

duke marrë në konsideratë interesin e përbashkët për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, garantimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e interesit publik,

duke marrë në konsideratë misionin dhe parimet që udhëheqin veprimtarinë e secilës Palë,

me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh në shkëmbimin e praktikave më të mira për inspektime, hetime disiplinore dhe për çështje me interes të përbashkët,

kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

NENI 1
Qëllimi

Objektivi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (MM) është forcimi i marrëdhënieve ndërinstucionale dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në lidhje me procedurat e verifikimit të ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për inspektimet institucionale dhe tematike.

NENI 2
Fushat e bashkëpunimit

Palët do të inkurajojnë dhe lehtësojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre për të bashkëpunuar, duke kuptuar se fushat e bashkëpunimit mund të

përfshijnë projekte dhe programe me interes të ndërsjelltë që lidhen me sa vijon:

- (a) shkëmbimin e praktikave dhe përvojave në lidhje me hetimin disiplinor të magjistratëve, si dhe me inspektimet institucionale dhe tematike;
- (b) shkëmbimin e informacionit mbi sistemin ligjor dhe legjislationin në fushën e procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe aktivitetet legjislative që lidhen me zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, masat e zbatimit të ligjit në fushat e juridiksionit të tyre dhe përvojën e tyre ndërkombëtare;
- (c) dhënien e këshillave mbi praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare të zbatueshme gjatë hetimeve disiplinore, duke përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (d) shkëmbimin e përvojave mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve tematike dhe institucionale dhe standardizimin e procedurave të inspektimit;
- (e) zhvillimin ndërmjet dy inspektorateve, të praktikave reciproke të punës, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe marrjen e praktikave më të mira;
- (f) shkëmbimin e përvojës në mjetet e komunikimit me publikun për të garantuar parimin e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe integritetit të magjistratëve;
- (g) forcimin e njohurive, përvojës dhe kapaciteteve të palëve nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe atyre të punës, takimeve për çështje me interes të përbashkët, aktiviteteve të përbashkëta trajnuese.

NENI 3

Forma e bashkëpunimit

1. Palët kuptojnë se bashkëpunimi mund të marrë formën e mëposhtme, kur është e përshtatshme dhe me interes të ndërsjelltë:

- (a) të mbajë kontakte dhe marrëdhënie profesionale ndërmjet tyre, të përditësojë përvojat dhe të shkëmbejë informacione të dhëna për legjislationin e vendeve përkatëse, që lidhet veçanërisht me shkëmbimin e teksteve të ligjeve dhe akteve nënligjore, materialeve analitike, statistikave dhe raporteve të inspektimit.
- (b) bashkëpunojnë në organizimin e konferencave të përbashkëta dhe/ose botimeve të artikujve në fushën e hetimit disiplinor të magjistratëve.
- (c) format specifike të bashkëpunimit Palët mund t'i vendosin me shkrim.

2. Palët do të bashkëpunojnë në përputhje me legjislationin e tyre përkatës kombëtar dhe kërkesat e tjera.

NENI 4 Shpenzimet

1. Përveç rastit kur bashkërisht vendosin ndryshe, secila Palë do të përballojë kostot e saj përkatëse sipas këtij MM.

2. Palët e kuptojnë se ky MM nuk i angazhon ato të mbështesin financiarisht asnjë aktivitet të kryer në bazë të tij.

3. Palët mund të shqyrtojnë, rast pas rasti, mundësi për të siguruar burime financiare dhe teknike për të mbështetur çdo bashkëpunim në përputhje me këtë MM.

4. Palët nuk kërkojnë rimbursimin e kostove që rrjedhin nga zbatimi i këtij MM, përveç rastit kur vendosin bashkërisht ndryshe rast pas rasti.

NENI 5 Plani i punës

Palët mund të krijojnë së bashku një plan vjetor pune me qëllim që të ndjekin aktivitetet që zhvillohen sipas këtij MM dhe të identifikojnë mundësi të reja për bashkëpunim.

NENI 6 Pika e kontaktit për Palët

1. Palët caktojnë si pikat e tyre përkatëse të kontaktit:

(i) Për ILD:

Këshilltar Ligjor

Kabineti i Inspektorit të Lartë të

Drejtnesisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",

Godina nr.13, Tiranë, Shqipëri

Email:

isida.koka@ild.al

(ii) Për IGJ:

Alin-Bogdan Alexandru

Serviciul secretariat

și relații publice

Bulevardul Regina Elisabeta, nr.

40, sector 5, București, Romania

Email:

registratura@inspectiajudiciara.ro

2. Palët mund të ndryshojnë pikën e tyre të kontaktit duke i dhënë një njoftim me shkrim palës tjetër.

3. Personat e kontaktit vazhdimisht i informojnë Palët për zbatimin e këtij MM.

4. Komunikimi do të kryhet në formë të shkruar ose nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit.

NENI 7
Dallimi në interpretim dhe zbatim

1. Palët do të zgjidhin çdo mospërputhje në zbatimin ose interpretimin e këtij MM me konsultime.
2. Në rast ndryshimi në interpretim, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

NENI 8
Statusi

1. Ky MM nuk është ligjërish i detyrueshëm.
2. Ky memorandum nuk krijon për Palët të drejta dhe detyrime të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare publike dhe as nuk cenon të drejtat ose detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse në të cilat Republika e Shqipërisë dhe Republika e Rumanisë janë palë.

NENI 9
Dispozitat përfundimtare

1. Ky MM do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij. Ai do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar.
2. Palët mund ta ndryshojnë këtë MM në çdo kohë me pëlqimin e tyre të ndërsjellë me shkrim. Çdo ndryshim i këtij memorandumi është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.
3. Secila Palë mund ta përfundojë këtë MM duke i dhënë një njoftim me shkrim tre muaj përpara Palës tjetër. Në një rast të tillë, ky MM do të pushojë së qeni në fuqi tre muaj pas datës në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin për përfundimin.
4. Palët mund ta ndërpresin këtë MM me pëlqimin e tyre të ndërsjellë me shkrim.

NËNSHKRUAR në Bukuresht më 8 (tetë) shkurt 2022, në gjuhën shqipe, rumune dhe angleze, në 6 (gjashtë) kopje, secili tekst është njëlloj autentik.

Për zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
të Republikës së Shqipërisë:

Artur Metani

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Për Inspektoratin Gjyqësor
të Republikës së Rumanisë:

Lucian Netejoru

Kreu i Inspektoratit Gjyqësor

Artur Metani



Lucian Netejoru